



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

RELACION PËR

PROJEKTLIGJIN PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9355 DATË 10.03.2005 “PËR NDIHMËN DHE SHËRBIMET SHOQËRORE”, TË NDRYSHUAR

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT

Qëllimi i këtij projektligji, është rishikimi i disa dispozitave të ligjit aktual nr.9355 datë 10.03.2005 “Për Ndhimën dhe Shërbimet Shoqërore”, të ndryshuar, të cilat kanë krijuar problematika në zbatimin e tij, përse i përket procedurës ligjore për përfitimin e ndihmës ekonomike.

II. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr.44/2016, për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, vendimmarrja për caktimin e familjes apo individëve në nevojë, përfitues të ndihmës ekonomike, i kaloi Strukturave Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, për një verifikim më të saktë, duke i dhënë të drejtën çdo familje apo individ, të aplikojë për ndihmë ekonomike.

Përpara këtyre ndryshimeve, vendimarrjen për përcaktimin e familjeve apo individëve përfitues të ndihmës ekonomike, e kishin Këshillat Bashkiakë.

Por në praktikë ndodh, që faza finale e verifikimit të të dhënave të aplikimeve si edhe gjenerimi i vendimit nga Struktura Rajonale e Shërbimit Social, për përfitimin e ndihmës ekonomike, bllokohet për shkak të mosmbledhjes së Këshillave Bashkiakë për të marrë vendim për propozim për familjet apo individët të cilët duhet të trajtohen me ndihmë ekonomike sipas aplikimeve që janë kryer, duke u mohuar familjeve apo individëve të drejtën ligjore për pagesën e ndihmës ekonomike.

Në Bashkinë Selenicë, muaji Tetor, ishte muaji i dytë mbas muajit Shtator, ku 200 banorë të cilët aplikuan për ndihmë ekonomike, e humbën të drejtën për ta përfituar atë, sepse Këshilli i Bashkisë, nuk u mbledh për të marrë vendim për propozimin që familjet apo individët në nevojë, të trajtohen me ndihmë ekonomike duke ia përcjell këtë vendim Shërbimit Social Shtetëror.

Kjo situatë, mund të përsëritet në vazhdim edhe në bashki të tjera të vendit, duke qenë se kushtëzimi i vendimmarrjes së Strukturave Rajonale të Shërbimit Social për gjenerimin e vendimit të përfitimit të ndihmës ekonomike, nga ardhja e Vendimit të Këshillit të Bashkisë, parashikohet në ligj.

Detyrimi i Këshillit të Bashkisë për të marrë vendim, përcaktohet në:

- Ligjin nr.9355 dt.10.03.2005 “Për ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore” Neni 29, pika 1 e tij, ku përcaktohen përgjegjësitë e Këshillit të Bashkisë për marrjen e vendimit për propozimin që familja apo individ në nevojë të trajtohen me ndihmë ekonomike duke përcaktuar masën përkatëse të përfitimit. Ky vendim i përcillet menjëherë, zyrtarisht, Strukturës Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror

Si edhe në:

- Vendimin e Këshillit të Ministrave, i cili ka dalë në zbatim të ligjit të mësipërm, me Nr. 955, datë 7.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”, Kreu II, Pika 6 dhe 7.
Në këtë Vendim të Këshillit të Ministrave, përcaktohet detyrimi i Këshillit të Bashkisë, i cili brenda datës 20 të çdo muaji, merr vendim për familjet apo individët përfitues të ndihmës ekonomike dhe ia përcjell Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.
Vetëm mbas ardhjes së vendimit për propozim nga këshilli bashkiak, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social, mund të verifikojë të dhënat e hedhura në Regjistrin Elektronik Kombëtar, të konfirmojë saktësinë e tyre dhe të gjenerojë vendimin për përfitimin e ndihmës ekonomike.

Parashikimi i kësaj hallke të vendosur në Nenin 29 pika 1 të ligjit dhe rrjedhimisht në pikën 6 dhe 7 ,Kreu II i VKM-së, pengon në mënyrë thelbësore vendimmarrjen e Shërbimit Social Shtetëror për verifikimin dhe gjenerimin e vendimit për përfitimin e ndihmës ekonomike, në rastet kur këshilli i bashkisë për arsye të ndryshme, nuk arrin të mbledhet brenda datës 20 të çdo muaji.

Ky parashikim ligjor, nuk ka asnjë efekt, sepse Shërbimi Social Shtetëror e administron Regjistrin Elektronik Kombëtar dhe kontrollon online të gjitha aplikimet që kryhen në sistem pranë administratorit shoqëror, që nga data 1 deri në datë 10 të çdo muaji.

Vendimi i Këshillit të Bashkisë, nuk është gjë tjetër veçse një listë referuar sistemit dhe parashikimi në ligj i kësaj hallke, nuk sjell asnjë efekt në evidentimin e familjeve që duhet të trajtohen me ndihmë ekonomike apo familjet që duhet të kenë prioritet për t’u trajtuar, pasi cilado familje apo individ, ka të drejtë të aplikojë për ndihmë ekonomike në sistem, pranë administratorit shoqëror.

Prandaj, nëpërmjet këtij projektligji, synohet heqja e detyrimit të këshillit të bashkisë, për të marrë vendim, për propozimin që familja apo individ në nevojë të trajtohen me ndihmë ekonomike, e përcaktuar në Pikën 1, të Nenit 29 të ligjit nr.9355 datë 10.03.2005 “Për Ndihmën

dhe Shërbimet Shoqërore” dhe përcaktimin e detyrimit që të dhënat e gjeneruara nga administratori shoqëror për familjet apo individët në nevojë që kanë aplikuar për ndihmë ekonomike, të përcillen në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, nga struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki.

Këto ndryshime të propozuara nga ky projektligj, sigurisht që nuk prekin kompetencat e strukturave përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki apo kompetencat e administratorit shoqëror në bashki, për të evidentuar familjet që kanë nevojë për ndihmë ekonomike, për verifikimin e gjendjes ekonomike të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike, për ndihmën e aplikuesve në përgatitjen e dokumentacionit si edhe detyra të tjera të përcaktuara në nenet 30/1 dhe 31 të ligjit.

Miratimi i këtij projektligji, do të thjeshtojë procedurën e përfitimit të ndihmës ekonomike, duke bërë të mundur që Strukturat Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror të cilat kanë kompetenca vendimmarrëse për gjenerimin e vendimit për përfitimin e ndihmës ekonomike, të mos varen nga Vendimi i Këshillit të Bashkisë i cili rrezikon të mos mblidhet në datën e caktuar, për aplikimet të cilat tashmë janë kryer dhe janë hedhur në Regjistrin Elektronik Kombëtar.

III. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Për këtë projektligj, janë përdorur si referencë, nenet 81 pika 1 dhe 83 pika 1 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Projektligji, është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

IV. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ky projektligj, është hartuar në 5 nene, të cilat propozojnë ndryshime në nenin 27/1, nenin 29, nenin 30/1 dhe nenin 31 të ligjit.

Konkretisht, dispozitat e projektligjit parashikojnë:

- Ndryshimin e Pikës 1 të nenit 27/1 të ligjit, për faktin se tashmë verifikimi i të dhënave nga Struktura Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, do të bëhet mbas përcjelljes të të dhënave nga struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki dhe jo mbas propozimit me vendim të këshillit bashkiak.
- Shfuqizimin e pikës 1 të nenit 29 të ligjit, e cila përcakton detyrimin e këshillit të bashkisë për të marrë vendim për propozim, si një hallkë e cila nuk sjell asnjë efekt në evidentimin e familjeve në nevojë, apo në faktin se cila familje duhet të ketë prioritet, pasi tashmë aplikimet janë kryer në Regjistrin Elektronik Kombëtar.
- Ndryshimin e pikës 1 të nenit 30/1 të ligjit, duke përcaktuar detyrimin e strukturave përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki, për të përcjellë në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, të dhënat e gjeneruara nga administratori shoqëror për familjet/individët në nevojë që kanë aplikuar për ndihmë ekonomike.
- Shfuqizimin e pikës 2 të Nenit 30/1 të ligjit, pasi me heqjen e hallkës së vendimit të këshillit të bashkisë për propozim, nuk është më e nevojshme hartimi dhe paraqitja në këshillin e

bashkisë së projektvendimit për propozim për familjet apo individët në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike.

- Ndryshimin e shkronjës “i” të nenit 31 të ligjit, përsa i përket detyrave të Administratorit Shoqëror, pasi me heqjen e hallkës së vendimit të këshillit të bashkisë për propozim, nuk është më e nevojshme që Administratori Shoqëror të kontribuojë në procesin e hartimit të projektvendimit për propozim për familjet apo individët në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike.

Miratimi i këtij projektligji, do të kërkojë gjithashtu të ndërhyhet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 955, datë 7.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike” si më poshtë:

- Ndryshimi i pikës 6, Kreu II, në përputhje me ndryshimet e propozuara në këtë projektligj, duke përcaktuar detyrimin e strukturës përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki, që brenda datës 20 të çdo muaji, të përcjell në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, të dhënat e gjeneruara nga administratori shoqëror për familjet/individët në nevojë që kanë aplikuar për ndihmë ekonomike.
- Ndryshimin e pikës 7 Kreu II, në përputhje me ndryshimet e propozuara në këtë projektligj, duke përcaktuar detyrimin e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, që mbas ardhjes nga struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki, e të dhënave të gjeneruara nga administratori shoqëror, të verifikoj të dhënat e hedhura në Regjistrin Elektronik Kombëtar, të konfirmoj saktësinë e tyre si edhe të gjenerojë vendimin për përfitimin e ndihmës ekonomike.

V. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Institucionet që ngarkohen për zbatimin e këtij projektligji janë Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror dhe bashkitë.

VI. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji i propozuar nuk ka efekte financiare që bëjnë të nevojshme rritjen e shpenzimeve të buxhetit të shtetit ose që pakëson të ardhurat e tij, pasi parashikon thjesht disa ndryshime ligjore, në procedurën e ndjekur për përfitimin e ndihmës ekonomike.

DEPUTETI

VULLNET SINAJ

